



Filloj > -Kronikë

“Shkozeti”/ Goditet grupi në Durrës, sekuestrohet drogë dhe municion luftarak

02 Prill, 2020 09:14 |




Madhësia e tekstit: - +

Policia e Durrësit informon se ka goditur një grup, të cilit i është sekuestruar drogë dhe municion luftarak.



Uniformat blu të qytetit bregdetar shprehen se operacioni është finalizuar, pasi është ndjekur për dy muaj me metoda pro aktive. Si rrjedhojë, dy persona u arrestuan, ndërsa njëri u procedua në gjendje të lirë.



Njoftimi i Policisë së Durrësit:

Durrës

Finalizohet një tjetër goditje e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve. Operacioni policor i koduar “Shkozeti”, ndjekur prej dy muajsh me metoda proaktive.



Arrestohen në flagrancë 2 shtetas, si dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër. Sekuestrohen një sasi dozash marijuanë, municion luftarak, peshore elektronike që shërbente për peshimin e lëndës narkotike, targa automjesh dhe aparate celular.

Specialistët për Hetimin e Trafikeve dhe Narkotikëve në Drejtorinë Vendore Durrës, në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, si dhe në bazë të një hetimi dymujor të ndjekur me metoda speciale të hetimit, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Shkozeti”, në kuadër të të cilit arrestuan në flagrancë shtetasit:

Sh. H., 34 vjeç dhe E. H., 22 vjeç, banues në Durrës, të dy të dënuar më parë për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Si dhe u procedua në gjendje të lirë për shkak të moshës, shtetasi I. H., banues në Durrës.

Gjatë operacionit, si rezultat i kontrollit të ushtruar në një magazinë në pronësi të shtetasve E. H. dhe SH. H., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale dhjetëra doza me marijuanë, 425 fishekë luftarak, një peshore elektronike, 2 palë targa, si dhe 4 aparate celular të markave të ndryshme.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, “Mbajta pa leje e armëve dhe municionit” dhe “Moskallëzimi i krimit”.

(d.xh/ Balkanweb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'u aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: policia e durrësit sekuestrohet arme dhe droge Shkozeti

TË NGJASHME



E rëndë në Durrës, 58 vjeçari vetëhidhet nga kati i gjashtë i pallatit, ndërrohet në vend

04 Mars, 2020




Tritol lokalit në zonën e Plazhit në Durrës, policia jep detajet: Si ndodhi ngjarja

29 Janar, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



“Do më fusni në burg? Nuk kam bërë ndonjë krim”, qytetari në lëvizje në mbrëmje në Sarandë, debat me policinë

02 Prill, 2020



“Arkivimi i çështjeve, efekte të pariparueshme”, Klodiana Lala: Paralizimi i drejtësisë nga COVID, pasoja në të ardhmen. Rrezikohen afatet e paraburgimit

02 Prill, 2020



Zbulohet me letra makine false dhe me cigare kontrabandë pas kontrollit në port, procedohet penalisht 39-vjeçari

02 Prill, 2020



Falsifikon dokumente dhe kryenin trafik njerëzish drejt SHBA, Kanadasë e Mbretërisë së Bashkuar, përfundojnë hetimet për 17 të akuzuarit

02 Prill, 2020



SPAK publikon emrat e 17 anëtarëve të grupit kriminal, trafikant qytetarë drejt SHBA-së, Kanadasë e Anglisë me viza false

02 Prill, 2020



“Nuk e meritoje këtë pabesi”, postimi prekës i mikut të ngushtë për 29-vjeçarin që vdiq në aksident: Iu luta Zotit të ishte shaka 1 Prill!


02 Prill, 2020

KATEGORIA VIDEO



Deklaratat në kohën e koronavirus/ Vasilj nxjerr videon: Me fat Kosova me Albinin, fatkeq Shqipëria me Ramën që ndjell vetëm zll

02 Prill, 2020



VIDEO/ I gjejnë test shtatzënie, dy djemtë dhunojnë barbarisht me grushte e shkelma vajzën

02 Prill, 2020



Ish-deputetja e PD sjell dëshmitë e qytetarëve: Ja si e rrëzojnë propagandën e shëmtuar të Ramës

02 Prill, 2020




“Gruaja shqiptare se askush tjetër”, ja çfarë bëri Emina Cunmulaj për bashkëshortin (Video)

02 Prill, 2020



“Gjuha e urrejtjes së Xhaqës zbulon se po fshihin skandalin”, Alibeaj: SPAK dhe Prokurori i Përgjithshëm të lënë korantinën, të nisin hetimin për tenderin e ushqimeve

02 Prill, 2020



Alessandra Ambrosio poston foto me bikini për fansat e saj

02 Prill, 2020